

MEKANIZMI I TRAJTIMIT TË ÇËSHTJEVE

Granti TF0B9998 "Mbështetja për procesin e projektit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri, (EITI)" i financuar nga Banka Botërore

Zbatimi i Iniciativës Nisma për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse (EITI) mbështet përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë për të përmirësuar qeverisjen dhe për të rritur transparencën në sektorët e energjisë, minierave, dhe naftës dhe gazit. Kjo ndihmë teknike për zbatimin e EITI-së në Shqipëri është në përputhje me Kuadrin e Partneritetit të Vendit (CPF) 2023-2027, dhe Përditësimin e Diagnostikës Sistematike të Vendit (SCD Update) "Shqipëria e Gjeneratës së Ardhshme". Transparencë më e madhe në shifrat e prodhimit të burimeve natyrore, shpërndarjen e licencave, pagesat dhe të ardhurat mund të rrisë mobilizimin e të ardhurave, të rrisë besimin e investitorëve potencialë dhe të rrisë zhvillimin e sektorit privat. Kjo mund të ndihmojë Shqipërinë në konsolidimin e kredibilitetit të saj me partnerët ndërkombëtarë publikë dhe private.

Përditësimi SCD për Shqipërinë gjithashtu identifikon përmirësimin e qeverisjes, transparencës, dhe përgjegjësisë së qeverisë si një prioritet themelor në arritjen e qëllimeve të Bankës Botërore. Zbatimi vazhdueshëm i EITI-së në Shqipëri kontribuon fort në këtë prioritet politik për përmirësimin e qeverisjes, transparencës dhe përgjegjësisë në sektorin ekstraktiv. Projekti i propozuar do të përdorë platformën EITI për të rritur njohuritë e strukturës ligjore dhe institucionale për investimet në sektorin e minierave, naftës dhe gazit me qëllim të përmirësimit të rritjes së përgjithshme të transparencës në sektorin e industrive nxjerrëse.

Aktivitetet e propozuara gjithashtu mbështesin komponentët tematike për strategjinë e Partneritetit të Qeverisë së Hapur të Shqipërisë 2020-2022 me mbështetje për përpjekjet kundër korrupsionit përmes zbatimit të pronësisë së reale, mbështetje për qeverisjen dixhitale përmes portalit të të dhënave të hapura dhe kadastrës minerare, dhe transparencën fiskale me publikimin e të dhënave të sektorit të industrive nxjerrëse.

Projekti është financuar nga Programi Mbështetës Global i Industrive Nxjerrëse (EGPS). Ai është në përputhje me Komponentin e Parë të EGPS "Përmirësimi i transparencës së të ardhurave nga sektori i industrive nxjerrëse dhe efikasiteti i sistemeve të menaxhimit publik" për të rritur ndikimin dhe efikasitetin e axhendës së transparencës.

Aktivitetet e projektit do të mundësojnë palët e interesit të EITI-t në Shqipëri për të përmirësuar qeverisjen e sektorit duke siguruar qasje në praktikën më të mira në qeverisjen e sektorit për institucionet kyçe në qeverinë qendrore dhe lokale) të përfshira në menaxhimin e sektorit nxjerrës përmes studimeve, trajnimeve dhe konsultimeve. Kështu, përfituesit do të përmirësojnë kapacitetet e tyre për monitorimin e pajtueshmërisë me strukturën ligjore dhe rregullatore dhe për angazhim në konsultime transparente në lidhje me rreziqet dhe avantazhet e sektorit të industrive nxjerrëse.

Projekti synon të arrijë rezultatet e mëposhtëme:

- Eliminimi i barrierave rregullatore për qasjen në të dhënat;
- Rritja e raportimit EITI nga organizatat publike dhe private;
- Përmirësimi i cilësisë dhe kohës së publikimit të të dhënave të sektorit ekstraktiv;
- Mbjajtja e statusit të validimit të Shqipërisë me “performancë domethënëse” ose më të mirë;
- Përmirësimi i angazhimit të qytetarëve dhe ndërgjegjësimi i tyre për menaxhimin e burimeve natyrore në nivelet lokale dhe kombëtare;
- Rritja e kapaciteteve për raportimin e ndryshimeve gjinore dhe impaktet mjedisore dhe sociale;

Për cdo pyetje ose kërkesë në lidhje me projektin ju lutem kontaktoni:

genci.terpo@infrastruktura.gov.al

sekretariati@albeiti.gov.al